



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar nga	26.01.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-10



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NË MES TË
QENDRËS SË TRAJNIMEVE DHE BURIMEVE PËR AVOKIM
I PËRFAQËSUAR NGA:
Z. KUSHTRIM KALOSHI, DREJTOR EKZEKUTIV

DHE
UNIVERSITETIT PUBLIK TË PRIZRENIT "UKSHIN HOTI",
I PËRFAQËSUAR NGA,
Rektori, Prof.Asoc.Dr. Samedin Krrabaj

Neni 1

Fushëveprimi

1. Fushëveprimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi, mbështetja dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes të subjekteve të lartëcekura.
2. Memorandumi synon të promovojë përpjekjet e përbashkëta të dy institucioneve në sferën e avancimit të çështjeve me interes reciprok.

Neni 2

Palët në memorandum

1. Palët në këtë memorandum janë:
 - 1.1 Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)
 - 1.2 Universiteti Publik i Prizrenit “Ukshin Hoti”

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët e lartëcekura do të bashkërendojnë aktivitetet për afirmimin e çështjeve aktuale në fushën e avancimit të jetës akademike dhe profesionale përmes:
 - 1.1. Realizimit të punës praktike për studentët e Fakultetit Juridik dhe fakulteteve të tjera relevante në kuadër të projekteve që zbatohen në Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim.
 - 1.2. Shkëmbimet e përvojave, praktikave të mira, ekspertëve dhe literaturës përkatëse për zhvillimin institucional, me qëllim të avancimit profesional dhe akademik të studentëve dhe stafit të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim.

1.3. Hartimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe kërkimore konform kërkesave dhe interesave të dy palëve.

1.4 Organizimin e përbashkët të veprimtarive akademike, shkencore dhe profesionale si; simpoziume, seminare, konferenca, tryeza, shkolla verore, trajnime.

1.5 ATRC, në kuadër të komponentës së monitorimit të gjykatave, monitorimit të institucioneve përgjatë implementimit të projekteve, përfshirë projektin e USAID për Drejtësi, do t'i angazhoj studentët nga Fakulteti Juridik dhe fakultetet e tjera relevante, me qëllim të monitorimit të rasteve gjyqësore.

2. Realizimin e formave të ndryshme të bashkëpunimit konform vullnetit dhe interesit të përbashkët.

Neni 4

Palët nënshkruese të këtij memorandumi të bashkëpunimit pajtohen si në vijim

1. Studentëve të Fakultetit Juridik dhe fakulteteve të tjera, sipas këtij memorandumi mund të angazhohen për punë praktike ose hulumtuese në Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, me kërkesë të veçantë.
2. Palët pajtohen që studentët nga Fakulteti Juridik, të cilët angazhohen në procesin e monitorimit të rasteve në gjykatat e Republikës së Kosovës duhet të jene te vitit të tretë (III), katërt (IV) të studimeve themelore, si dhe studentët e studimeve master.
3. Palët pajtohen që angazhimi i studentëve të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" të bëhet përmes thirrjeve publike brenda Fakultetit, të cilat përgatiten dhe zbatohen nga Universiteti i

Prizrenit “Ukshin Hoti”, respektivisht nga Qendra për Karrierë dhe Alumni në koordinim me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim.

4. Palët pajtohen se përzgjedhja e studentëve për angazhim në punë praktike në Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, do të bëhet nga ana e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” nëpërmjet komisionit i cili do të përbëhet në bazë të kriterëve si më poshtë:
 - 4.1. Komisioni vlerësues themelohet nga dekani i njësisë akademike i cili do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë, ku dy (2) nga anëtarët e komisionit duhet të jenë përfaqësues jashtë sferës së interesit, përzgjedhjen e të cilëve e bën Qendra për karrierë dhe Alumni e UUHP.
 - 4.2. Komisioni vlerësues së bashku me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim do t’i përcaktoj kriteret e vlerësimit.
 - 4.3. Komisioni vlerësues do ta informoj me transparencë të plotë, Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, duke i përcjellur dokumentet e vlerësimit të studentëve dhe numrin e pikëve të vlerësimit.
5. Me rastin e angazhimit të studentëve të zgjedhur në procesin e monitorimit të rasteve gjyqësore, dhe institucioneve të drejtësisë, ata/ato nënshkruajnë një kontratë të angazhimit, e cila përmban të drejtat dhe detyrimet. Kontrata nënshkruhet nga përfaqësuesi ATRC-së dhe studenti/ja i angazhuar.
6. Palët pajtohen që shpenzimet e angazhimit të studentëve të Fakultetit Juridik në punë praktike do të mbulohen nga ATRC, bazuar në vlerat e aprovuara nga donatori dhe fondet në dispozicion.
7. Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” merr përsipër që varësisht nga nevojat e projekteve të implementuara nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, të inkurajojë studentët, me theks të veçantë studentët nga komunitetet jo-shumicë, që të aplikojnë në thirrjet publike të cilat organizohen për angazhimin e studentëve në punë praktike.

8. Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” merr përsipër që të vë në dispozicion sallat, me qëllim të realizimit të trajnimeve nga ATRC, për studentët që do të marrin pjesë në programin e punës praktike nga projektet e ndryshme, përfshirë edhe punën praktike në kuadër të projektit të USAID për Drejtësi.

Neni 5

Mirëbesimi

1. Palët pajtohen që ky memorandum, të zbatohet në mirëbesim profesional, bazuar në parimet e përcaktuara në nenin 2.

Neni 6

Koordinimi i palëve dhe zbatimi

1. Palët pajtohen që të mbajnë takime të rregullta koordinuese me qëllim të zbatimit të këtij memorandum.
2. Me qëllim të zbatimit të këtij memorandum, palët caktojnë personat kontaktues.

Neni 7

Kohëzgjatja

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe ka efekte juridike në kohë të pacaktuar, konform vullnetit dhe interesave të përbashkëta.

Neni 8
Ndërprerja

1. Ky memorandum bashkëpunimi mund të ndërpritet në çdo rast të mos respektimit të pikave të marrëveshjes nga të dyja palët.
2. Ndërprerja e këtij memorandumi bëhet me paralajmërim me shkrim, së paku 30 ditë para.

Neni 9
Ndryshimi dhe amandamenti

Ky memorandum bashkëpunimi mund të rishikohet, ndryshohet dhe plotësohet në bazë të pajtimit paraprak ndërmjet palëve nënshkruese.

Neni 10
Ekzemplarët e Memorandumit

Ky memorandum bashkëpunimi nënshkruhet në dy ekzemplarë të njëjtë, nga një ekzemplar për secilën palë.

PALET

**QENDRA E TRAJNIMEVE DHE
BURIMEVE PËR AVOKIM**

**Drejtori Ekzekutiv,
Z. Kushtrim Kaloshi**



**UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"Ukshin Hoti"**

**Rektori i UUHP
Prof.Asoc.Dr. Samedin Krrabaj**

